



Raport nga procesi i konsultimit publik me qytetarë për Draft-Rregulloren për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Administratën Komunale

Institucioni organizator: Komuna e Istogut

Drejtoria përgjegjëse: Drejtoria e Administratës

Komuna e Istogut ka zhvilluar konsultim publik lidhur me Draft-Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale. Qëllimi ishte rritja e transparencës dhe informimi i publikut mbi strukturën organizative të administratës.

Draft-rregullorja përcakton ndarjen e përgjegjësi, funksionet organizative dhe sistemimin e vendeve të punës, me synim rritjen e efikasitetit dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët.

Gjatë konsultimit, u diskutua rëndësia e administratës funksionale, profesionalizmit dhe qasjes së barabartë në shërbime. Qytetarët dhanë komente lidhur me nevojën për administratë më të qasshme dhe më efikase.

PËRFUNDIM

Komentet e marra do të shqyrtohen dhe do të reflektohen në versionin final të rregullores.